



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Tiranë më 13.05.2015

Dokument Parlamentar

RAPORT

**PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, NR.9043, DATË 10.04.2015
“PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 23/2015 “PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË “**

1.0 HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 13/05/2015, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës, nr.9043, datë 10.04.2015 “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 23/2015 “PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË “

2.0 ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Me Dekretin nr. 9043, datë 10.04.2015, Presidenti i Republikës vendosi kthimin e ligjit nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë “

Nisur nga përmbajtja e materialit shpjegues të Dekretit të Presidentit të Republikës, rezulton se arsyet për kthimin e ligjit janë si më poshtë vijon:

Rregullimet ligjore të parashikuara në lidhje me shërbimin diplomatik duket se do të ndikojnë në drejtimin e politizimit të diplomacisë .

2.1.Së pari: - Në nenin 4 të tij Parimet e Shërbimit të Jashtëm përcakton se “*Shërbimi i Jashtëm është pjesë përbërëse e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë dhe vepron në bazë të parimeve të profesionalizmit, integritetit, paanësisë politike , transparencës, shërbimit ndaj publikut, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë, si dhe korrektësisë në zhvillimin e legjislacionit*”

Këto parime referuar rregullimeve ligjore lidhur me përzgjedhjen e krerëve të misioneve diplomatike si dhe dhënies së gradave do të bëjë që këto parime të mbeten formale dhe të mos zbatohen.

2.1.1. Për të argumentuar këtë pretendim se pari i referohet nenin 27 paragrafi i parë dhe i dytë “Kreu i misionit diplomatik”. Bazuar në përmbajtjen e këtij neni ligji nuk ka vendosur asnjë kufizim për përzgjedhjen e personave jashtë sistemit të diplomacisë, duke bërë të mundur, që në çdo rast të shpërfilllet trupa e diplomatëve me grada në Republikën e Shqipërisë.

2.1.2. Kjo mënyrë përzgjedhje e personave jashtë sistemit të diplomacisë, krijon mundësinë që shërbimi i jashtëm të politizohet jashtë mase. Kriteret kufizuese të parashikuara në nenin 35 të ligjit, i referohen statusit politik të kandidatit, në momentin e përzgjedhjes si kreh misioni, por nuk përjashton mundësinë e politizimit të këtij shërbimi.

2.1.3. Kriteret shtesë të vendosura për përzgjedhjen jashtë sferës së diplomacisë pika (d) dhe pika (e) janë shumë evazive dhe lënë mundësi për interpretime të ndryshme.

2.2. Së dyti: Neni 27 paragrafi i tretë, përcakton se kandidaturat në Misionin e Jashtëm përzgjidhen nga një komision i Posaçëm i cili propozohet nga Ministri i Punëve të Jashtme Ky komision i zgjedhur nga Ministri, i cili është një pozicion politik duke mos patur dhe një përcaktim të qartë sa i takon numrit të kërreëve të misioneve që vijnë nga diplomatët e karrierës dhe atyre që vijnë jashtë sistemit, në çdo rast është i ekspozuar nga ndërhyrjet e politikës.

2.2.1. Ligji përmban detaje të panevojshme për procedurën e krijimit, funksionit dhe kompetencave të komisionit të posaçëm të cilat shumë mirë mund të rregulloheshin përmes rregullores apo akteve të tjera nënligjore.

2.2.2. Është e paqartë mënyra se si përzgjidhen anëtarët e komisionit dhe mënyra se si do të funksionojë ky komision dhe a do të marrë vendime.

2.3 Së treti: Në paragrafin e katër të nenit 26 të ligjit përcaktohet se “Përpara emërimit të ambasadorit nga Presidenti i Republikës, Komisioni për Politikën e Jashtme organizon seancë dëgjimore me kandidatin për t’u emëruar ambasador dhe i përcjell Presidentit të Republikës opinionin për kandidaturën e propozuar

Nuk është përcaktuar qartë momenti se kur do të thërritet në seancë dëgjimore kandidati i propozuar .

2.3.1. Nuk është përcaktuar procedura që do të ndiqet nga Komisioni për Politikë të Jashtme

2.3.2. Nuk është përcaktuar afati kohor kur ky komision do të dërgojë raportin tek Presidenti i Republikës. Ky përcaktim është i nevojshëm, kur ligjvënësi ka përcaktuar dhe një afat kohor që Presidenti të shprehet.

2.4. Së katërti: Në paragrafin e dytë të nenit 26 përcaktohet se “ambasadori emërohet dhe lirohet nga Presidenti i Republikës, jo më vonë se 30 ditë pas propozimit të Kryeministrit. Në kushtet kur ligji nuk përmban afate ligjore për komisionin e posaçëm, Ministrin apo Kryeministrin është e papranueshme të përmbajë afate për Presidentin e Republikës.

2.4.1. Neni 26/2 i ligjit 23/2015 në lidhje sa më sipër i ka kapërcyer caqet e vendosura nga Kushtetuta. Ky nen ka cënuar parimin e hierarkisë së normave (neni 116 i Kushtetutës).

2.4.2. Në ligj nuk është parashikuar se çfarë ndodh nëse Presidenti i Republikës nuk shprehet në 30 ditë.

2.5 *Së pesti*: Në nenin 36 të ligjit është përcaktuar se pranimi në shërbimin e jashtëm bëhet përmes konkursit të hapur në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin 'Për nëpunësin civil dhe në këtë ligj. Nuk kuptohet se çfarë vlere ka konkurrimi i hapur në shërbimin e jashtëm kur në nenin 27 dhe 31 përcaktohet se përmes emërimeve në përfaqësitë diplomatike mund të punësosh pa kufizim persona nga jashtë sistemit të diplomacisë.

2.6. *Së gjashti*: Në nenin 47 të ligjit parashikohet se në dhënien e gradave ngrihet një Komision i Karrierës, i cili referuar nenit 52 të ligjit përcakton se përbëhet nga pesë anëtarë. Vlerësoj se kandidatët për grada të larta "ambasador" duhet të dëgjohen edhe në Komisionin e Shërbimit të Jashtëm para se t'i propozohen Presidentit të Republikës.

2.6.1. Është e paqartë dhe e pasigurt mënyra si do të përzgjidhen anëtarët e komisionit dhe mënyra se si do të funksionojë dhe si do të marrë vendime ky komision.

2.6.2. Në paragrafin e tretë të nenin 47 të ligjit parashikohet se numri i ambasadorëve, ministrave fuqplotë dhe ministrave këshilltarë mbetet të përcaktohet në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm. Në këtë mënyrë zhvishet shërbimi i jashtëm nga një shërbim në funksion të vendit dhe që kërkon një konsensus politik të veçante dhe kthehet në shërbim të Ministrisë dhe partisë në pushtet të radhës.

3.0. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

1. *Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
2. *Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

3.2 Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. *Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.*
2. *Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.*

4.0 SHQYRTIMI I ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, Dekreti i Presidentit u shqyrtua në Komisionin për Politikën e Jashtme si komision përgjegjës në mbledhjen e datës 13.05.2015

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm z. Qirjako Qirko Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe z. Armand Skrapi Drejtor në Drejtorinë e Traktateve dhe së Drejtës Ndërkombëtare.

Në diskutimet e përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe deputetëve të mazhorancës u paraqitën argumente në mbështetje të ligjit 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” duke arsyetuar se kthimi i ligjit 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” nga Presidenti i Republikës dhe argumentet e përdorura prej tij, nuk përbëjnë shkaqe Kushtetuese .

Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë ka si synim kryesor konsolidimin e mëtejshëm të aktivitetit të këtij shërbimi mbështetur në parimet mbi të cilat funksionon Shërbimi Civil i Republikës së Shqipërisë, të cilat janë sanksionuar në nenin 4 të tij.

Në shqyrtimin e arsytimit të parë të Dekretit se neni 27 paragrafi 2 bie ndesh me parimet e sanksionuara në nenin 4 të ligjit, komisioni arsyetoi se neni 27 paragrafi 2 është në përputhje me nenin 4 të ligjit . Me këtë formulim, ligji synon që kandidaturat për ambasadorë jashtë sistemit të karrierës diplomatike përzgjidhen bazuar në kriteret tërësisht profesionale .

Në lidhje me arsyetimin e dytë të dekretit të Presidentit të Republikës për Komisionin e Posaçëm, i cili propozon kandidaturat për ambasador parashikuar në nenin 27 paragrafi 2, krijimi i tij me urdhër të Ministri të Punëve të Jashtme është bazuar në nenin 102 paragrafi 4 të Kushtetutës i cili parashikon se:

Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Ndryshe nga sa parashtrohet në arsyetimin e tretë të dekretit, ligji rregullon procesin e emërimit të Ambasadorit nga Presidenti i Republikës në përputhje të plotë me normat kushtetuese. Neni 92 paragrafi dh) i Kushtetutës parashikon se Presidenti “*me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare*”. Kjo normë qartëson se procesi i emërimit të ambasadorit kalon vetëm nga dy institucione: Kryeministri dhe Presidenti i Republikës

Neni 26 paragrafi 4 i ligjit parashikon, gjithashtu, se: “*Përpara emërimit të ambasadorit nga Presidenti i Republikës, Komisioni për Politikën e Jashtme i Kuvendit zhvillon një seancë dëgjimore me kandidatin për ambasador*”. Procedura e zhvillimit të kësaj seance dëgjimore është e përcaktuar qartë në Rregulloren e Kuvendit .

Në Dekretin e Presidentit si arsye të katërt për kthimin e ligjit është përmbajta e nenit 26 paragrafi 2, e cila parashikon se “*Ambasadori emërohet dhe lirohet nga Presidenti i Republikës, jo më vonë se 30 ditë pas propozimit të kryeministrit* “ Komisioni arsyeton se përmbajta e nenit 26 paragrafi 2, është në përputhje me Kushtetutën dhe në asnjë rast nuk kufizon kompetencën e Presidentit për të emëruar ose liruar ambasadorin, e cila mbetet një e

drejtë ekskluzive e këtij institucioni. Kjo dispozitë nuk vjen ndesh me nenin 116 të Kushtetutës pasi vendosja e afatit kohor nuk cenon të drejtën e Presidentit të parashikuar në nenin 92 paragrafi dh) të Kushtetutës.

Saktësimi i afateve kohore të parashikuara në nenin 26, paragrafi 2, është në përputhje dhe me vendimet nr.9/2007 dhe nr.10/2015 të Gjykatës Kushtetuese të cilat shtrojnë domosdoshmërinë e hartimit të normave ligjore sa më të qarta dhe të kuptueshme me qëllim që të shmangen interpretimet dhe kuptimet evazive .

Komisioni për pikën pesë dhe gjashtë të Dekretit arsyeton se argumentat e përdorura prej tij nuk kanë shkaqe kushtetuese. Parashikimet e nenit 27 dhe 31 paragrafi 3 të cilat citohen nga Dekreti i Presidentit të Republikës nuk kanë pasur si synim cënimin e profesionalizmit të Shërbimit të Jashtëm dhe të sistemit të karrierës diplomatike.

Vendosja e kriterëve të sakta profesionale për përzgjedhjen e kandidatëve të lartpërmendur nga një strukturë brenda shërbimit të jashtëm, siç është Komisioni i Posaçëm që do të ngrihet për këtë qëllim, shmang abuzivizmin që mund të lindë si pasojë e keqinterpretimit të dispozitave të lartpërmendura.

Ligji 23/2015 ‘Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë’ synon të garantojë parimin kushtetues të sigurisë juridike të diplomatëve të karrierës së Shërbimit të Jashtëm .

Ligji, në rregullimin që i bën procesit të dhënies së gradës personale Ambasador nga Presidenti i Republikës, synon vlerësimin e karrierës diplomatike në përputhje me eksperiencën kohore dhe profesionale të kandidatëve për gradën më të lartë diplomatike. Dhënia e kësaj grade, është rezultat i një vlerësimi të brendshëm të Shërbimit të Jashtëm përmes Komisionit të Karrierës Diplommatike. Për më tepër, në hartimin e kësaj dispozite është mbajtur parasysh dhe eksperiencia e vendeve të tjera. Përcaktimi i hierarkisë në sistemin e gradave diplomatike është në përputhje me cilësitë dhe eksperiencën profesionale të diplomatëve.

Deputetët e opozitës në diskutimet e tyre theksuan se ligji krijon hapësira për politizimin e këtij Shërbimi. Deputetët e opozitës mbështeten arsyet e parashtruar nga Presidenti i Republikës në Dekretin nr. 9043 datë 10.04.2015 “Për kthimin e ligjit 23/2015”Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë “.

Në përfundim të diskutimeve, shumica e deputetëve të pranishëm u shprehën për rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës dhe propozuan kalimin e tij në seance plenare, duke shprehur bindjen se aktet nënligjore në zbatim të ligjit duhet të reflektojnë veretjet që deputetët trajtuan gjatë shqyrtimit shterues në Komision

Arta DADE

KRYETARE